



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 16, datë 15.02.2019**

**PËR**

**MIRATIMIN E AGJENTIT NË SIGURIME, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË  
SHOQËRISË SË SIGURIMIT “SIGMA INTERALBANIAN VIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 194, pika 4, nenit 199, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Licencimin e shoqërisë së agjentëve në sigurime “S.A.S” sh.a., për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, në klasat e Jo-Jetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit “Sigma Inter-albanian VIG” sh.a.
2. Miratimin e z. Andi Rakipi për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, në klasat e Jo-Jetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë së agjentëve në sigurime “S.A.S” sh.a.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin KOÇI**